

VENDIM
Nr.18, datë 14.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH
SHA PËR PERIUDHËN 1 MARS 2008 – 28 SHKURT 2009

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “b”, 9, 26, pika 1, 27, dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.28, datë 24.6.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike për shoqërinë publike të gjenerimit”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.2.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për miratimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a.,

VENDOSI:

Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën 1 mars 2008 – 28 shkurt 2009, është 0.78 lekë/kWh.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Ere-s
Bujar Nepravishta